



***Startklar 2021 – Aktivitete
shumëgjuhëshe për familjet me
prejardhje emigracioni për fazën
e kalimit nga çerdhja në
shkollën fillore***

Informacione për familjet me prejardhje emigracioni

Aktivitetet për familjet me fëmijë janë përgatitur në vitin 2020 brenda AG Rucksack të shoqatës KI NRW për kalimin nga çerdhja në shkollën fillore, duke u mbështetur profesionalisht nga LaKI (qendrat e integritit të landeve dhe ato komunale).

Për shkak të kërkesës që vazhdon të jetë e madhe, broshura është rishikuar në vitin 2021, dhe është përditësuar dhe përkthyer në gjuhë të tjera.

Ofrimi i këtij materiali për familjet në kohën e pandemisë synon të krijojë ura lidhjeje dhe nuk pretendon të jetë i plotë dhe nuk duhet të kuptohet si një zëvendësim i përpjekjeve në këtë fazë tranzicioni përmes ofertave të rregullta.

Autoret dhe autorët:

KI Bottrop, KI Duisburg, KI Gelsenkirchen, KI Rrethi Recklinghausen, KI Rrethi Viersen, Zyra e koordinimit në nivel landi Qendrat komunale të integritit NRW (LaKI), MKFFI NRW 2021

Fotografitë dhe ilustrimet:

© MKFFI NRW 2021

E disponueshme edhe në gjuhë të tjera:

Shqip, arabisht, bullgarisht, anglisht, farsi, greqisht, kurmanji, italisht, polonisht, romanisht, rumanisht, rusisht dhe turqisht.

Aktivitetet me fëmijën

Ky jam unë dhe bëj këtë gjë

Kur një fëmijë hyn në shkollë për herë të parë, ai është një fillestar, por me siguri nuk është fillestar në të mësuar!

Në fund të fundit, ai ka gati 6 vjetë që ka ardhur në jetë dhe gjatë kësaj kohe ka mësuar shumë gjëra.



Detyrë: **Vizatimi me shkumës „Ky jam unë“**




Gjeni me fëmijën tuaj jashtë një sipërfaqe toke të bukur dhe të drejtë, mbi të cilën mund të vizatoni mirë me shkumës. Pastaj mund të bëni këto gjëra:

- 1) Fëmija juaj qëndron i shtrirë në dysheme dhe ju vizatoni rreth trupit të tij me shkumës.
- 2) Tani ndërrohuni. Ju shtriheni në dysheme pranë fotos së fëmijës tuaj me pak hapësirë dhe fëmija juaj do të vizatojë skicën e trupit tuaj.
- 3) Flisni me fëmijën tuaj se çfarë mungon akoma dhe vizatojeni edhe atë si p.sh.: sytë, hunda, veshët, goja, flokët, veshja...
- 4) Shkruani emrat mbi vizatimet me shkumës.
- 5) Tregojini njëri-tjetrit atë që ju pëlqen veçanërisht shumë dhe pikturojini gjërat përreth vizatimit tuaj: akullore, lodër, kafshë ...
- 6) Tani flisni se çfarë gjëje di të bëjë mirë secili prej jush dhe pikturojeni edhe atë: duke luajtur futboll, duke kënduar, duke u ngjitur. Në vend të vizatimit, mund edhe ta demonstroi dhe tjetri duhet ta hamendësojë se për çfarë është fjala.
- 7) Bisedoni me fëmijën tuaj edhe për gjëra që dëshironi akoma t'i mësoni dhe pikturojini edhe këto.
- 8) Në fund bëni edhe një fotografi të bukur të vizatimeve që keni bërë. Ndoshta fëmija me fillimin e shkollës dëshiron që ta marrë me vete në shkollë këtë vizatim. Ai e ndihmon për t'u prezantuar dhe i jep kurajo!

Detyrë: Ditari im „Këtë di ta bëj“

Kur fëmija juaj e ndjen se atij i besohen detyra dhe aktivitete vetëm, kjo gjë i jep kurajo dhe vetëbesim. Në një fazë kur fillon diçka e re kjo është e rëndësishme. Prandaj flisni shumë me fëmijën tuaj dhe pyeteni se më çfarë dëshiron ai të merret atë ditë ose çfarë detyrash dëshiron të marrë përsipër (p.sh. të ujisë lulet, të shtrojë tavolinën, të ndihmojë në gatim ose në pjekje).



- 1) Merrni fletë të bardha letre dhe palosini ato në një fletore të vogël ose blini një fletore të gatshme pa vija.
- 2) Nga pjesa e përparme fëmija juaj ngjit një foto të vetën dhe shkruan edhe emrin e vet aty.
- 3) Tregojini fëmijës suaj se fletorja është një ditar për fëmijë. Çdo ditë fëmija vizaton një faqe për atë se çfarë ka bërë ai atë ditë ose se çfarë ka arritur të krijojë vetëm. Akoma më bukur është nëse edhe ju gjithashtu shkruani diçka në të. Pyeteni fëmijën tuaj se çfarë duhet të shkruani poshtë:

Shembull: Sot kam shtruar tavolinën. Sot kam lëvizur me skuterin. Sot kam pikturuar një vizatim pranvere.

Çfarë i jap unë me vete fëmijës sim në fazën e re të jetës „Shkolla“?


Detyrë: Kaushi i shkollës

Varni një figurë të një kaushi shkolle bosh në një mur në apartamentin tuaj dhe mbusheni atë gjatë javëve të ardhëshme me „fëmijën tuaj“, derisa ai të fillojë shkollën. Në kaushin simbolik të shkollës mund të futet gjithçka që ju i keni dhënë fëmijës gjatë viteve të fundit, si p.sh. dashurinë për fëmijën, besimin, leximi i librave me figura, të luajturit intensiv, vizatimin dhe punëdoren, dashurinë për njerëzit e tjerë dhe kafshët...



Do t'ju bien ndërmend edhe shumë më tepër gjëra!


- 1) Për çdo veçori dhe çdo aktivitet fëmija juaj vizaton një simbol dhe e pret atë. Ja disa sugjerime:



- 2) Ngjiteni bashkë me fëmijën tuaj këtë simbol në kaushin e shkollës. Dy ose tre herë në javë shtoni nga një simbol të ri me fëmijën tuaj.
- 3) Caktoni bashkë me fëmijën tuaj një moment fiks gjatë ditës, p.sh. përpara se të shkojë për të fjetur, dhe vështroni bashkë kaushin e shkollës. Flisni për simbolet në kaushin e shkollës si dhe për kuptimin që kanë ato për ju. Kështu, fëmija juaj forcohet për të kaluar në „hapësirën e re të jetës“, që është shkolla.

Formati i kaushit të shkollës

Prerja.



Udhëzime për përgatitjen e një kaushi shkolle

Bëni një kon shkolle bashkë me fëmijën tuaj për ditën e parë të shkollës!

Cfarë ju nevojitet:


- 1) një karton me ngjyra (format A1 ose A2)
- 2) një laps, një gërshërë, një lidhëse 1m e gjatë
- 3) letër krep (elastike) me ngjyra dhe një fjongo me ngjyra
- 4) ngjitës, ngjitës i lëngshëm ose shirit ngjitës i dyanshëm
- 5) letër punëdore me ngjyra për zbukurim




Udhëzimi:




- 1) Shtrijeni letrën e punëdores dhe lidhni lidhësen rreth lapsit.



- 2) Mbajeni lidhësen të tendosur në këndin (A) dhe vizatoni me laps një hark nga (B) tek (C).




- 3) Tani me fëmijën tuaj mund të prisni kuadratin përgjatë harkut.




- 4) Vendosni tani shiritin e dyanshëm ngjitës ose ngjitësin në njërën anë të gjatë të kuadratis.



- 5) Rrotullojeni kartonin në formë kaushi. Maja nuk duhet të ketë asnjë hapje.



- 6) Ngjisni një copë drejtkëndëshe letre krep brenda kaushit. Ky drejtkëndësh është 5 cm më i gjatë se sa hapja e rumbullakët e kaushit dhe afërsisht 35 cm i lartë.



- 7) Zbukurojeni kaushin me gjëra që i pëlqejnë shumë fëmijës suaj. Pyesni fëmijën. P.sh. në një fletë punëdoreje më të hollë pikturoni gjërat e preferuara të fëmijës suaj, pritini ato dhe ngjitini në kaush.

Kalofshi bukur!

Rruga për në shkollë

Gjatë rrugës për në shkollë ka shumë për të mësuar

Edhe pse në kohët e sotme shumë rrugë bëhen me makinë, rruga e shkollës është një fushë mësimi shumë e mirë. Gjatë rrugës për në shkollë fëmija juaj mëson

shumë gjëra: të orientohet, të racionalizojë kohën, të përshtatet për ditën e shkollës, të orientohet me qarkullimin rrugor dhe të respektojë rregullat e rëndësishme të tij, të dallojë zonat e rrezikut dhe mbi të gjitha, të mësojë se sa kënaqësi dhe sa mirë është që të lëvizësh në ajër të pastër!

Kush shkon me këmbë në shkollë, është në formë dhe i shëndetshëm, është më i balancuar, më i pavarur dhe mund të orientohet më mirë. Prindërit kanë rolin e rëndësishëm për ta shoqëruar në fillim fëmijën në mënyrë të sigurt gjatë rrugës për në shkollë, si dhe për të qenë një shembull i mirë për ta.



i Në një **udhëzues të plotë për rrugën e shkollës**, ADAC i ka vënë në dispozicion për prindërit në mënyrë shumë të konkretizuar (edhe në gjuhë të thjeshtë) të gjitha informacionet e nevojshme, që janë ekskluzivisht për një fillim të sigurt të periudhës shkollore: Mund të shkarkohen falas në faqen zyrtare www.adac.de, duke e kërkuar me Schulwegratgeber (Udhëzuesi i rrugës së shkollës)

Praktikimi së bashku është i rëndësishëm dhe jep siguri

Në mënyrë që fëmija juaj të jetë i sigurt gjatë rrugës për në shkollë dhe të orientohet mirë, ju duhet ta bëni këtë rrugë bashkë me fëmijën tuaj. Merrni rregullisht pak kohë për ta bërë këtë rrugë dhe për ta njohur mirë.

Jo gjithmonë rruga më e shkurtër është edhe më e sigurta. Gjeni atë rrugë që ka më pakë vende me rrezik. Këtu gjeni disa ide se si mund të praktikohet mirë rruga për të shkuar në shkollë dhe siguria në trafik:

Detyrë: Veshje e sigurtë

Ngjyrat e lehta dhe të ndritshme shihen më mirë nga drejtuesit e automjeteve dhe kjo është më e sigurt. Reflektorët në veshje dhe çantat e shpinës mund të duken veçanërisht mirë në errësi.



Këto ushtrime mund t'i bëni me fëmijën tuaj:

- 1) Së bashku me fëmijën tuaj vishni rroba të errëta duke errësuar një rëndomë. Provojeni bashkë se sa e vështirë është që ju ta shihni njëri-tjetrin.
- 2) Tani ndërrojeni veshjen dhe vishni rroba në ngjyrë të hapur ose të ndritshme: A mund të shikoheni më mirë në errësi?
- 3) Ose bëni disa fotografi me blic në errësi me veshje në ngjyrë të çelët/të ndritshme dhe më pas me veshje në ngjyrë të errët! Cilat veshje mund të shikohen më mirë në fotografi?
- 4) Ju më pas mund të merrni pjesë në një garë selektimi me veshje. Në një shportë hidhen të gjitha veshjet, që dallohen mirë edhe në errësi, dhe në një shportë tjetër veshjet, që në errësi nuk mund t'i dallosh mirë.
- 5) Detyrë për fëmijën: Pikturojeni veshjen dhe çantën e shpinës së fëmijëve në mënyrë të tillë që ato të dallohen mirë edhe në errësi.
- 6) Tani diskutoni me fëmijën tuaj se përse është e rëndësishme veshja e rrobave me ngjyra të çelta ose të ndritshme.

Formati i veshjes së sigurt



Pikturoje veshjen dhe çantën e shpinës së fëmijëve në mënyrë të tillë që ato të dallohen mirë edhe në errësirë.

Detyrë: Rruga e sigurt për në shkollë

Bëjeni disa herë bashkë rrugën e shkollës. Gjatë rrugës flisni me fëmijën tuaj për të gjitha rregullat dhe vendet e rreziqeve. Me fëmijën tuaj mund të bëni këto ushtrime:



- 1) Merrni me vete shkumës dhe të gjitha vendet e rreziqeve shenjojini me një **!** në ngjyrë të kuqe. Diskutoni gjithmonë arsyet, në mënyrë që fëmija ta ketë të qartë përse klasifikohet si rrezik.
- 2) Herën e dytë fëmija juaj ndoshta mund ta shënojë vetë shenjën **!**
- 3) Herën e tretë ju mund të ndërroni rolet. Tani është fëmija nëna ose babai, që shpjegon të gjitha rregullat e rëndësishme dhe vendet e rreziqeve.
- 4) Rrugën e shkollës fëmija juaj mund ta pikturojë bashkë me juve. Bëni që vizatimi të krijohet gjatë një bisede: „Çfarë ke parë rrugës?“ Cilat janë vendet me rrezik gjatë rrugës? Cilat vende i preferon më shumë gjatë rrugës? Sa herë duhet ta kapërcejmë një rrugë?“ Në çfarë drejtimi duhet të shkojmë në fillim?“

Në trafik është shumë e rëndësishme që të respektohen rregullat. Këto ushtrime mund t'i bëni me fëmijën tuaj:

- 1) Nëse rregullat i praktikoni në formë rime, fëmija do të jetë në gjendje t'i fiksojë më mirë:
 - „Me të kuqe qëndro, me jeshile vazhdo.“
 - „Bëhu i mençur dhe shiko me kujdes“
 - „Nëse dua të kaloj në rrugë, në fillim, së pari duhet të shikoj majtas, djathtas dhe pastaj të shikoj përsëri majtas.“
 - "Trotuari është aty për të ecur, sigurisht që çdo fëmijë e di këtë".

Rregullat fiksohen mirë edhe përmes këngëve për rregullat e qarkullimit, si p.sh. me këngën për të dalluar të majtën nga e djathta të Rolf Zuckowskit. Dëgjojeni dhe këndojeni bashkë edhe në Youtube.



Ne faqen zyrtare të Rolf Zuckowskit gjeni tekstin e plotë të këngës për ta shkarkuar:

<https://www.musik-fuer-dich.de/liedtexte/>


Detyrë: **Semafori**

Ngjyrat sinjalizuese jeshile dhe e kuqe janë shumë të rëndësishme. Këto ushtrime mund t'i bëni me fëmijën tuaj:



- 1) Fëmija juaj pikturon semaforin poshtë në ngjyrën e kuqe, portokalli dhe jeshile.
- 2) Tani mendoni bashkë disa lëvizje (kërceni në një rën këmbë, vraponi, vallëzoni, kërcimi krik me krahët sipër kokës....)
- 3) Tregoni me gisht rrethin jeshil, filloni lëvizjen me fëmijën tuaj. Nesë tregoni pastaj me gisht rrethin portokalli dhe menjëherë më pas rrethin e kuq, lëvizja duhet të ndërpritet.
- 4) Tani mund të ndërroni edhe rolet! Shpjegojini fëmijës suaj se në çdo rast nuk mund të ndalemi në mes të rrugës, por duhet të vazhdojmë të ecim shpejt, edhe kur semafori kalon në të kuqe!

Formati i semaforit



Pikturoni semaforin në ngjyrë të kuqe, portokalli dhe jeshile.



***Urojmë për ju dhe fëmijën tuaj gjithë të mirat
dhe gëzim në këtë rrugëtim!***